



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236321

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05929116

AC-I.-23-0121

Në ankesën e

Paditësja

V D nga Prishtina, të cilën e përfaqëson avokat G A nga Prishtina.

kundër

E paditura/Ankuesja

N.SH NewCo "Grand Hotel SH.P.K", (në likuidim) të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1378, të datës 09 shkurt 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Reformulohet ex officio pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1378, të datës 09 shkurt 2023, ashtu që do të jetë teksti " Aprovohet pjesërisht si e bazuara ankesa/ kërkesa e paditëses dhe ndryshohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN173-**

0471 i dt. 24 qershor 2015, Obligohet e paditura N.SH NewCo "Grand Hotel SH.P.K", që paditëses V D për paga të papaguara për periudhën nga dhjetori i vitit 2011 deri në gusht të vitit 2012, t'ia paguaj shumën prej 1,851.10 euro, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 124.00 euro, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.

3. Vërtetohet pika II e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-1378, të datës 09 shkurt 2023.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 20 korrik 2015, paditësja e dorëzoi në DHPGJS një ankesë/ kërkesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRN173-0471, të datës 24 qershor 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditëses për pagesën e pagave të pa paguara në shumë prej 2,036.21 € nga N.SH "NewCo Grand Hotel", Prishtinë për periudhën dhjetor 2011 deri më 06 gusht 2012, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësja në ankesë e kundërshton vendimin e ankimuar duke pohuar se nuk qëndron konstatimi se kërkesa është parashkruar. Ajo pohon se kërkesat në bazë të nenit 371 të LMD-së parashkruhen në afatin prej pesë viteve, ndërsa natyra e kërkesës që ka të bëjë me ushqimin në bazë të nenit 373.3 të LMD-së nuk parashkruhet. Tutje paditësja në ankese pohon se në këtë ndërmarrje ajo ka punuar në periudhën e lart cekur pavarësisht se kush ishte pronari, ndërsa AKP-ja e ka pas në menagjim këtë ndërmarrje dhe nuk i ka kryer obligimet ndaj punëtorëve. Tutje ajo pohon se me shkresën e AKP-së nr.246 të datës 07. Gusht 2012, janë njoftuar punëtorët se kërkesat për paga në mënyrë meritore do të shqyrtohen nga Autoriteti i Likuidimit në procedurën e likuidimit. Paditësja ka theksuar se kërkesën në AKP e ka parashtruar më 18 mars 2015, brenda afatit ligjor. Bashkë me ankesë paditësja ka dorëzuar, autorizimin për përfaqësim të avokatit G A, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN 173-0471, Njoftimin për likuidimin e Ndërmarrjes të datës 02 shkurt 2015, listën e pagave të pa paguara per periudhën 10/2011 deri 08/2012 te nënshkruar dhe vulosur, ku emri i paditëses është me nr. rendor 48, vendimi nga Sindikata 02 prill 2007, Parashtrësja e hartuar nga punëtorët për AKP-

në, më datë 20 shkurt 2012, Njoftimi për AKP-në datë 26 mars 2012, përgjigja e Lëshuar nga AKP, M T zëvendës Drejtore, drejtuar Shoqatës së Sindikatës të datës 07 gusht 2012, Vendimi i Shoqatës së pavarur të Sindikatës të datës 24 prill 2012.

Me 29 nëntor 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS-ë mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore. AKP-ja në parashtresë të mbrojtjes ka pohuar faktin se NSH,, New co Grand Hotel shpk” ka hyrë në procedurë të likuidimit më datë 02 shkurt 2015, ndërsa paditësja më datë 18 mars 2015 ka ushtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën prej 2,036.21 euro për periudhën dhjetor 2011 deri më 08 gusht 2012. Në këtë parashtresë AKP-ja pohon se paditësja ka dështuar të paraqesë cila dispozitë ligjore e Ligjit të AKP-së është shkelur me vendimin e Autoritetit të Likuidimit. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa është parashkruar në kuptim të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi që paditësi nuk ka sjellë ndonjë dëshmi që i ka kërkuar këto paga më parë në ndonjë gjykatë kompetente. Pasi që kërkesa është parashkruar, AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit nuk ka pasur mundësi t’i shqyrtojë meritat e rastit. Nga këto arsye, AKP-ja kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar. Parashtresës ja ka bashkangjitur, Formularin e kërkesës kreditore, Njoftimin e datës 02 shkurt 2015.

Me 09 shkurt 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-1378, ankesën e paditëses e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar, e ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit PRN173-0360, dt.27 maj 2015 si dhe ka obliguar NSH-në -AKP-në ti paguaj paditëses V D pagat e papaguara shumën 1,851.10 euro për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri më gusht 2012,, si dhe për shpenzimet të procedurës shumën 124.00 euro sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa për pagat e papaguara për periudhën e lart cekur nuk është parashkruar siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, pasi që Shoqata sindikale e punëtorëve të NSH-së me datë 20.02.2012 e kishte paraqitur kërkesën në emër të punëtorëve në AKP- dhe kishte kërkuar pagesën e pagave të papaguara të punëtorëve. Kjo kërkesë e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës dhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar. Tutje shkalla e I-rë konstaton se me Përgjigjen e AKP-së të datës 07.08.2012, vërtetohet fakti se AKP-ja ka qenë e njoftuar me

situatën e mos pagesës së pagave të punëtorëve të NSH-së, si kundër që me këtë përgjigje punëtorët janë njoftuar se kërkesat e tyre për paga do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit. AKP kishte theksuar se kërkesat në paga do të shqyrtohen apo që punëtorët do të udhëzohen në inicimin e kontestit civil për pagimin e pagave. Shkalla e I-rë ka vlerësuar se në rastin konkret duke marrë për bazë pagën mujore 240 euro, sikundër edhe faktin se nga Komisioni i të paditurës, Lista e nënshkruar nga Drejtori Financiar S Z, paditëses si punëtorë V D ju është llogaritur paga për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri në muajin gusht të vitit 2012, në shumën 1,851.10 euro Gjykata duke u mbështetur në këtë dokument vërtetoi se paditësja e ka bazën e juridikë të kërkesës deri në lartësinë e shumës 1,851.10 euro, ndërsa mbi këtë shumë e deri në shumën e kërkuar 2,036.21 euro paditëses i mungon baza juridike e kërkesës, paditëses kërkesa ju është refuzuar.

Tutje shkalla e I-rë ka konstatuar se nuk është lëshuar në aspektin e vlerësimit të lartësisë së kërkuar, meqë e paditura nuk e ka kontestuar lartësinë e shumës se kërkuar sikurse edhe mos pagesën e pagave. Shkalla e I-rë ka konstatuar me provat të cilat i ka paraqitur paditësi vërtetohet se ai ka kryer shërbime pune për NSH-në në periudhën e cekur, andaj është aprovuar shuma në emër të pagave të papaguara 1,851.10 €, që do të paguhet në bazë të nenit 40.1.1.7 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, ndërsa vendimin e AL PRN173-0471, të datës 24 qershor 2015, PRN137 e kishte ndryshuar.

Me 27 shkurt 2023, AKP-ja e dorëzon një ankesë të afatshme kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-1378 të datës 09 shkurt 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e saj si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet padia e paditëses si e pa bazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se me Aktgjykimin e ankimuar nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike, është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale dhe nuk janë marrë në konsideratë argumentet ligjore të dhëna në vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe në mbrojtjen në ankesë. Tutje AKP-ja pohon se gjetjet faktike të gjykatës janë tërësisht jashtë kontestit faktik të çështjes dhe plotësisht të pa bazuara në ndonjë dokument që ekzistojnë në dosje të lëndës. Tutje AKP-ja pohon se Aktgjykimi i ankimuar nuk i plotëson kushtet e përcaktuara nga neni 54 i LDHP-së, pasi që nuk pasqyron drejtë gjendjen faktike e cila ka rëndësi materiale lidhur me kërkesën. Tutje AKP-ja pohon se neni 40.1.6.2 i Shtojcës se

Ligjit të AKP-së i jep të drejtë dëmshpërblimi vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasoje apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja, e që në këtë rast paditëses nuk i është pushuar marrëdhënia e punës me veprimin e AKP-së. Është pikërisht për këtë arsye që Autoriteti i Likuidimit ka refuzuar kërkesën për paga të pa paguara pasi që paditësja nuk ishte punëtorë aktive në momentin kur filloi likuidimi-ky i fundit një veprim i ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.2 Rrjedhimisht duke qenë se nuk ishte në marrëdhënie pune aktive me NSH-në, në momentin kur NSH-ja hyri në likuidim, nuk kishte se si marrëdhënia e tij e punës të ndërpritej nga një veprim i ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit nr.04/L034. Andaj paditësja nuk ka të drejtë në pagat e pretenduara ndaj NSH-së. Tutje AKP-ja pohon se gjykata duhet të lëshohet në shqyrtimin e çështjes dhe të marrë në konsideratë argumentet e ngritura të Autoritetit të Likuidimit.

Me 27 shkurt 2024, përfaqësuesi i paditëses e pranoi ankesën e AKP-së, mirëpo nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP) Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet, megjithatë Riformulohet ex officio pika I e dispozitivit të Aktgjykimit të Shkallës së I-rë i DHPGJS-së së C-IV-15-1378, të datës 09 shkurt 2023.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me 18 mars 2015 ka parashtruar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit me të cilën ajo ka kërkuar të paguhen pagat e pa paguara për

periudhën dhjetor 2011 deri në gusht 2012 nga NSH New Co "Grand Hotel" Prishtinë, në shumë prej 2,036.21 €. Kjo kërkesë ishte refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditëses si të bazuar, e ka ndryshuar Aktgjykimin e ankimuar dhe e ka obliguar AKP-në të i'a paguaj paditëses pagat e pa paguara për periudhën dhjetor të vitit 2011 deri më gusht të vitit 2012 në shume prej 1,851.10 €, duke konstatuar se kërkesa për paga nuk është parashkruar. Pjesën tjetër të kërkesës përtej shumes së aprovuar e ka refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësja me ankesën e saj të dorëzuar në Shkallen e I-rë e ka kundërshtuar vendimin e AL PRN173-0471, të datës 24 qershor 2015 dhe si dëshmi ka bashkangjitur: autorizimin për përfaqësim të avokatit G A, vendimin e Autoritetit të Likuidimit, PRN 173-0471, Njoftimin për likuidimin e Ndërmarrjes të datës 02 shkurt 2015, listën e pagave e të pa paguara për periudhën 10/20011 deri 08/2012 të nënshkruar dhe vulosur, ku emri i paditëses është me nr. rendor 48, vendimi nga Sindikata 02 prill 2007, Parashtresa e hartuar nga punëtorët për AKP-në, më datë 20 shkurt 2012, Njoftimi për AKP-në datë 26 mars 2012, përgjigja e Lëshuar nga AKP, M T zëvendës Drejtore, drejtuar Shoqatës së Sindikatës të datës 07 gusht 2012, Vendimi i Shoqatës së pavarur të Sindikatës të datës 24 prill 2012.

Në bazë të këtyre provave vërtetohet se Shoqata Sindikale e Punëtorëve të NSH-së me datë 24 korrik 2012 e kishte paraqitur një kërkesë në emër të punëtorëve në AKP, duke kërkuar prej saj që të paguhen pagat e mbetura borxh për periudhën e cekur. Po ashtu në AKP në emër të punëtorëve të NSH-së ishte dorëzuar një kërkesë për paga të pa paguara edhe më herët, me datë 20 shkurt 2012.

Në bazë të kërkesës së parë, AKP-ja me datë 06 gusht 2012 e kishte paraqitur një përgjigje për shoqatën sindikale të punëtorëve të NSH-së, në të cilën përgjigje AKP-ja i referohet kërkesës të datës 24 korrik 2012, dhe i udhëzon punëtorët që kërkesat për paga do të shqyrtohen në procedurën e likuidimit, pasi që NSH-ja të hyje në likuidim.

Duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së se kërkesa nuk është parashkruar siç pretendon Autoriteti i Likuidimit në vendimin e ankimuar, ngase kërkesa e punëtorëve të NSH-së me datë 20.02.2012 e paraqitur në emër të punëtorëve në AKP- për pagesën e pagave të papaguara dhe në bazë të pohimit të borgjit nga e paditura për pagat e papaguara për periudhën 12/20011 deri 08/12 të nënshkruar dhe vulosur nga Drejtori financiar i N.SH "NewCo Grand Hotel", e kishin ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës dhe nuk mund të konsiderohet se kërkesa është parashkruar.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se AKP-ja në përgjigjen në ankesë nuk e ka kontestuar shprehimisht lartësinë e kërkuar të kompensimit në emër të pagave të pa paguara, andaj duke u bazuar në këtë fakt dhe në listën e pagave të cilën paditësja e ka sjellë si provë, Shkalla e I-rë e DHPGJS me të drejtë e ka aprovuar pjesërisht shumën prej 1,851.10 €, në emër të pagave të pa paguara për periudhën e cekur, e cila shumë do të paguhet nga ana e AKP-së sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e I-rë në piken I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar kur i referohet ndryshimit të vendimit të AL në vend që të përshkruaj vendimin PRN173-0471 të dt. 24 qershor 2015, të cilën pala paditëse e kishte ankimuar dhe në arsyetimin të aktgjykimit Shkalla e I-rë vet është referuar të njëjtit vendim të AL, ndërsa gabimisht në dispozitiv të Aktgjykimit ka shënuar vendimin e AL PRN173-0360 të dt. 27 maj 2015, prandaj duke vërejtur këtë gabim teknik Kolegji i Apelit ex officio e riformulon vetëm piken I të dispozitivit të Aktgjykimit C-IV-15-1378 të dt. 09 shkurt 2023, ndërsa pika e II e dispozitivit të Aktgjykimit vërtetohet.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 14 mars 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 korrik 2024

Mr. Sc Sahit Sylejmani , Gjyqtar kryesues
